



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:134657

Datë: 16.11.2024

Numri i dokumentit: 06462408

C.nr.2551/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Edije Sezairi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.H. nga Reqanë Prizren, me numër personal R.F. nga Prizreni, me numër personal E.H. nga Lubinje Poshtme Prizren, me numër personal M.R. nga Prizreni, me numër personal dhe A.R. nga Prizreni, me numër personal të cilët me autorizim e përfaqëson av. A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës M.F.P.T.- Departamenti i Pensioneve, Prishtinë, Ndërtesa e Qeverisë së Kosovës, me objekt të kontestit kompensimi i pensionit shtesë sipas shkallës së inflacionit, jashtë seancës gjyqësore, më datë 16.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil shpallet JOKOMPETENTE në pikëpamje lëndore dhe HEDHET POSHTË SI E PALEJUESHME padia e paditësit B.H., nga Reqanë Prizren, R.F. nga Prizreni, E.H. nga Lubinje Poshtme Prizren, M.R. nga Prizreni, dhe A.R. nga Prizreni, me numër C.nr.2551/2024 e datës 13.05.2024, kundër të paditurës M.F.P.T.- Departamenti i Pensioneve, Prishtinë, për shkak të kompensimit të pensionit shtesë sipas shkallës së inflacionit.

A r s y e t i m

Paditësi B.H. nga Reqanë Prizren, me numër personal R.F. nga Prizreni, me numër personal E.H. nga Lubinje Poshtme Prizren, me numër personal M.R. nga Prizreni, me numër personal dhe A.R. nga Prizreni, me numër personal përmes të autorizuarës të tij av. A.H. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës M.F.P.T.- Departamenti i Pensioneve, Prishtinë, Ndërtesa e Qeverisë së Kosovës, me objekt të kontestit kompensimi i pensionit shtesë sipas shkallës së inflacionit.

Kjo gjykatë, me rastin e shqyrtimit paraprak të padisë, gjeti se çështja e cila është objekt i këtij kontesti, nuk përbën çështje gjyqësore, por e njëjta përfaqëson çështje administrative sipas Ligjit 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore.

Sipas Ligjit 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, me nenin 13 është përcaktuar që “varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual, në

fund të çdo viti për vitin e ardhshëm, Qeveria e Kosovës me propozimin e Ministrisë së Financave, me vendim të veçantë, do të vendosë për lartësinë e shumës së pensioneve të përcaktuara me këtë ligj”. Ndërsa me nenin 14 par. 4 i të njëjtit ligj parashihet që “Ministria e Financave, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 2002/1 mbi metodologjinë e caktimit të lartësisë së pensionit bazë në Kosovë, do të jetë përgjegjëse për llogaritjet që kërkohen nga ky ligj dhe për përcaktimin e nivelit të rritjes së pagesave të pensioneve të përcaktuara me këtë ligj”. Tutje, neni 18 par. 1 i të njëjtit Ligj përcakton që “departamenti përkatës për pensione i Ministrisë, është përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e skemave pensionale të përcaktuara me këtë ligj”. Kurse me nenin 19 par. 1 të këtij Ligji përcaktohet se “të drejtën në pension parashtruesi i kërkesës e realizon përmes parashtrimin të kërkesës në Ministri”.

Në kuptim të dispozitave të cituara më lartë, kjo gjykatë vlerëson çështja e pensioneve është kompetencë e organeve administrative, përkatësisht e Departamentit përkatës për pensione i cili funksionon në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Së këndejmi, kërkesa e paditësit për mbrojtje gjyqësore sipas padisë, nuk mund të realizohet në procedurë kontestimore dhe as në procedurë të konfliktit administrativ, për faktin se lidhur me kontestin e natyrës së tillë, gjykatës i mungon kompetenca gjyqësore për vendosje për çështjen e ngritur me padi.

Në këtë mënyrë, gjykata vlerëson se janë plotësuar prezumimet procedurale që të veprohet në kuptim të dispozitës së nenit 18 par. 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e cila përcakton që “kur gjykata gjatë procedimit të çështjes konstaton se për zgjidhjen e kontestit nuk është kompetente gjykata veçse ndonjë organ shtetëror tjetër, do të shpallet inkompetente, do t’i shpallë të pavlefshme të gjitha veprimet procedurale të kryera dhe do ta hedhë poshtë padinë që i është paraqitur”. Lidhur me këtë, dispozita e nenit 391 par. 1 pika a) përcakton se “pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: a) çështja e ngritur me padi nuk hynë në kompetencën gjyqësore”.

Nga të cekurat më lartë, gjykata në kuptim të dispozitës së nenit 17, 18 par. 1, 18 par. 2, 19 dhe 391 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.2551/2024, datë 16.11.2024

Gj y q t a r i
Edije Sezairi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.